



Pranuar / Dorezuar Punë/Profato Received/Delivety	12.11.2020	viti god year	0
Org.in /Mjesia Organ /Jednica Org /Unit	SKOMSHCK	Nr. Prot It. Prot Prot No	2562/2020
		Shtojca Prilog Appendix	
		Sasia Kolicina Quantity	1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.276/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.276/2020 të datës 18.09.2020 të parashtruar nga ankuesi [REDACTED] më adresë banimi Rr. "Rrahim Beqiri", nr.1/3-2 në Prishtinë, kundër Vendimit me Nr.095/2020 të datës 09.09.2020 të Zyrës së Kryeministrit, në çështjen juridike "transferim i detyrueshëm", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pa bazuar Ankesa Nr.276/2020 e datës 18.09.2020 e parashtruar nga ankuesi [REDACTED]
- II. MBETET në fuqi Vendimi Nr.Prot:78-1-2020 i datës 09.09.2020 i Drejtorit të Departamentit për Asistencë Zhvillimore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.
- III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

A r s y e t i m

Me datë 01.08.2017, [REDACTED], Udhëheqës i Teknologjisë Informative në Ministrinë e Integritimeve Evropiane, ka pezulluar marrëdhënien e punës në Ministrinë e Integritimeve Evropiane, me qëllim të ushtrimit të mandatit të deputetit në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Pas mbarimit të mandatit të deputetit, ankuesi, me datë 26.08.2020 përmes komunikimit me e-mail ka kërkuar nga zyrtaret përgjegjës të Ministrisë së Integritimeve Evropiane që t'i mundësohet kthimi në pozitën e njëjtë si Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike në Ministrinë e Integritimeve Evropiane.

Drejtori i Departamentit për Asistencë Zhvillimore, në cilësinë e zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit, më datën 09.09.2020 ka nxjerr Vendimin me Nr.Port:78-1-2020 përmes të cilit nëpunësin e ka transferuar në pozitën e punës "Udhëheqës i Divizionit për Politika Sociale, Arsim dhe Shëndetësi", me arsyetimin se pozita e Udhëheqësit të Divizionit për Teknologji Informative dhe Shërbime të Logjistikes, është e plotësuar.

Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin me Nr.Port:78-1-2020 të datës 09.09.2020 të Drejtorit të Departamentit të Asistencës Zhvillimore në Zyrën e Kryeministrit, me datën 18.09.2020 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1814/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.09.2020, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Udhëheqësi i Divizionit për Burime Njerëzore në Zyrën e Kryeministrit, ndërsa më datë 01.10.2020 ka pranuar përgjigjen në ankese me shkresat e bashkangjitura.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me kërkesë të Kryetarit të Kolegjit për shqyrtimin e ankesave, më datë 28.10.2020 ka nxjerr vendimin VK.nr.11/2020 përmes të cilit ka vendosur të shtyhet afati i vendosjes për ankesën A.nr.276/2020 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1814/2020 të datës 18.09.2020 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës: Vendimin me numër të protokollit 78-1/2020 të datës 09.09.2020 për transferimin e ankuesit nga pozita "Udhëheqës i Divizionit të Teknologjisë Informative" në pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Politika Sociale Arsim dhe Shëndetësi"; Akt emërimin me numër të protokollit 843-1/2012 të datës 08.05.2012; Emalin e datës 18.09.2020: Formularin e regjistrimit të ankesës të datës 18.09.2020; Kërkesën për përgjigje në ankese me numër të protokollit 1877/2020 të datës 29.09.2020 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 1956/2020 të datës 01.10.2020 të Burimeve Njerëzore të Zyrës së kryeministrit drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës: Vendimin me numër të protokollit 1491-1-2017 të datës 07.08.2017 për pezullimin e dakorduar të marrëdhënies së punës: Kërkesën me numër të protokollit 1478/2017 të datës 04.08.2017 për pezullimin e pozitës: Akt emërimi me numër të protokollit 1706-1-2019 të datës 23.09.2019; Certifikatën me numër 395/12 të datës 29.12.2012; Certifikatën e datës 17.10.2014; Certifikatën e datës 27.02.2004; Certifikatën e datës 21.01.2004; Emalin e datës 26.08.2020; Formularin e Planit Individual të Personelit; Kërkesën me numër të protokollit 2329/2020 të datës 28.10.2020; Draft Përshkrimin e detyrave të punës: Vendimin VK.nr.11/2020 të datës 28.10.2020 për vazhdimin e afatit për vendosje:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit, *është e pa bazuar, sepse:*

Ankuesi pretendon se pas përfundimit të periudhës së pezullimit të dakorduar të marrëdhënies së punës, me rastin e transferimit të tij në pozitën e punës të Udhëheqësit të Divizionit për Politika Sociale, Arsim dhe Shëndetësi, nuk janë zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët

Publikë, për arsye se: kualifikimi dhe përvoja e tij e punës nuk përputhen me pozitën e punës të cilin është transferuar, dhe; të hyrat financiare të kësaj pozite nuk janë të njëjta me pozitën që ka ushtruar para pezullimit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në Akt Emërimin me numër protokolli 843-1-2012 të datës 08.05.2012 ka konstatuar se ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune në pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike" në Ministrinë e Integrimi Evropiane, deri me datë 01.08.2017. Ankuesi, duke u bazuar në dispozitat e nenit 89 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me datë 01.08.2017 e ka pezulluar marrëdhënien e punës në Ministrinë e Integrimi Evropiane, deri në përfundimin e ushtrimit të mandatit të deputetit në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se ankuesi pas përfundimit të mandatit të deputetit, përmes e-mailit të dërguar me datë 26.08.2020 ka kërkuar nga zyrtaret përgjegjës të Ministrisë së Integrimi Evropiane që t'i mundësohet kthimi në pozitën e tij të punës si Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike në Ministrinë e Integrimi Evropiane.

Duke marr parasysh se me vendimin Nr.01/09 të datës 01.07.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, strukturat organizative të Ish Ministrisë së Integrimi Evropiane, nga data 01.07.2020 janë zhvendosur në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, Drejtori i Departamentit për Asistencë Zhvillimore, në cilësinë e zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit, më datën 09.09.2020 ka nxjerr Vendimin me Nr.Port:78-1-2020 përmes të cilin ankuesin e ka transferuar në pozitën e punës "Udhëheqës i Divizionit për Politika Sociale, Arsim dhe Shëndetësi", me arsyetimin se pozita e Udhëheqësit të Divizionit për Teknologji Informative dhe Shërbime të Logjistikës, është plotësuar me nëpunës civil të karrierës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, vlerëson së Zyra e Kryeministrit me rastin e aprovimit të kërkesës për rikthim në Shërbim Civil të ankuesit dhe transferimin e tij në pozitën e kategorisë së njëjtë "Udhëheqës i Divizionit për Politika Sociale, Arsim dhe Shëndetësi", ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 58 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *Pas përfundimit të pezullimit, përveçse kur vendoset përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, sipas këtij ligji, nëpunësi civil rikthehet në pozitën e mëparshme të punës ose në rast se pozita e mëparshme është e plotësuar përfundimisht, ai transferohet në një vend tjetër të së njëjtës kategori.* Pra, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se ankuesit i është mundësuar kthimi në Shërbim Civil, pas përfundimit të mandatit të funksionarit publik, siç ka qenë e përcaktuar në piken 3 të vendimit me numër protokolli 1491-1-2017 për pezullim të marrëdhënies së punës, mirëpo meqenëse pozita e mëparshme e punës është plotësuar përfundimisht me nëpunës civil të karrierës, organi punëdhënës ka qenë i obliguar të transferojë ankuesin në pozitë të kategorisë së njëjtë siç parashihet me nenin 53 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *Transferimi i përhershëm është caktimi i detyrueshëm i nëpunësit civil në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil, në rastet: të përfundimit të pezullimit me kërkesë të nëpunësit civil kur ai nuk mund të kthehet në pozitën e mëparshme të punës, dhe nenin 10 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, i cili përcakton se: Transferimi i përhershëm është caktimi i detyrueshëm i nëpunësit civil në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil në rastet: të përfundimit të pezullimit me kërkesë të nëpunësit civil kur ai nuk mund të kthehet në pozitën e mëparshme të punës.* Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në përshkrimin e vendit të punës të pozitës së Udhëheqësit të Divizionit për Politika Sociale, ka konstatuar se kriteret e pranimit për këtë pozitë

të punës janë: *Studime universitare në fushën e ekonomisë, integritet evropian, politika publike, administratës publike ose të ngjashme*, andaj, vlerëson se organi punëdhënës me rastin e transferimit ka marr parasysh përgatitjen profesionale të ankuesit, për faktin së ankuesi i ka të përfunduara studimet themelore në fushën e ekonomisë përkatësisht në programin Menaxhment dhe Informatikë, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit është i pa bazuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka shqyrtuar edhe pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me dëmtimin në të ardhurat financiare pas transferimit dhe ka konstatuar se meqenëse transferimi është bërë në pozitë të kategorisë së njëjtë me pozitën e mëparshme edhe paga bazë është njëjtë. Ndërsa lidhur me shtesën mbi pagën bazë në emër të pozitës deficitare të cilën ankuesi e ka realizuar gjatë ushtrimit të pozitës së mëparshme si Udhëheqës i Divizionit të Teknologjisë Informative, Kolegji vlerëson së një nëpunës civil nuk mund të realizojë shtesë mbi pagën bazë përderisa nuk e ushtron pozitën e punës për të cilën është e aprovuar shtesa, për faktin se shtesa mbi pagë bazë për pozitën deficitare është e lidhur drejtpërdrejtë me titullin e punës, andaj Kolegji vlerëson se ankuesi me rastin e parashtrimit të kërkesës për pezullim të marrëdhënies së punës duke u thirrur në dispozitat e nenit 89 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, ka qenë në dijeni me pasojat juridike që mund të krijoj pezullimi dhe është pajtuar për pezullim të marrëdhënies së punës, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të të gjitha të lartcekurave dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, konstaton se Vendimi me Nr. Prot: 78-1-2020 i datës 09.09.2020 i Drejtorit të Departamentit për Asistencë Zhvillimore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, është nxjerr në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.276/2020

Ilire Mehmeti Shaqiri

Procesmbajtëse

Jeton KOÇA
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit [REDAKTUAR]
- Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Zyrën e Kryeministrit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së